

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sistemet e avancuara të AI-së rrezikojnë njerëzimin, tre rivalët e teknologjisë i bashkon frika e humbjes së kontrollit
ADRESA	https://piranjat.al/bota/sistemet-e-avancuara-te-ai-se-rrezikojne-njerezimin-tre-rivalet-e-teknologj-i103987
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:37:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:18:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56368c6c95d5485009ab88610d749d168923d1e9f009d18e35779ebdb481d74c
TEKSTI	736b4cce06421a1860c5127bb52acd8d511080b8ed50b08a5f185811b1ad1183
PAMJA	7d84477b30cc7df6b00bb6ec8b79a05cc7b86fdae93610845b1dd5fb9eeda01a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dfec29e915b33b7f8eb4641bfc2aef1c223992135d2ffffbd9130ad90d67ef69
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bfff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/dfec29e915b33b7f8eb4641bfc2aef1c223992135d2ffffbd9130ad90d67ef69

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **u zhduk** arriti t'i shqyrtojë vonë **shpallet** në kërkim person plagosi **shesh:** aksioni qytetar shënon **çekiç! Ne** kërkim autori **në Gjermani** larta në 10 vitet e fundit, dhe

BOTA

Sistemet e avancuara të AI-së rrezikojnë njerëzimin, tre rivalët e teknologjisë i bashkon frika e humbjes së kontrollit

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 09:18



Tre prej figurave më të fuqishme dhe rivale të Intelligjencës Artificiale kanë gjetur një pikë të rrallë dakordësie: sistemet më të avancuara mund të jenë duke u zhvilluar më shpejt sesa aftësia e njerëzve për t'i kontrolluar.

Drejtuasi i Anthropic, Dario Amodei, u bëri thirrje kompanive të ngadalësojnë përmirësimin e aftësive të modeleve të AI-së, duke argumentuar se përparimi teknologjik është përshpejtuar ndjeshëm gjatë muajve të fundit.

Sipas tij, shkak i kryesor është aftësia në rritje e Intelligjencës Artificiale për të ndihmuar në krijimin e modeleve pasardhëse, një proces që njihet si "vetëpërmirësim rekursiv". Nëse vazhdon pa masa sigurie, ky proces mund të ecë më shpejt se aftësia njerëzore për ta kuptuar dhe kontrolluar.

Thirrja e Amodei-t mori mbështetjen e menjëhershme të drejtuesve të dy kompanive rivale.

"Dario ka të drejtë", shkroi Elon Musk, drejtuesi i xAI, ndërsa shpërndau propozimin e tij.

Edhe drejtuesi i OpenAI, Sam Altman, deklaroi se kompanitë duhet të kontrollojnë ritmin e zhvillimit të modeleve më të fuqishme.

Altman mbështeti gjithashtu propozimin që ekspertëve të pavarur t'u jepet akses i vazhdueshëm, i ngjashëm me atë të punonjësve, për të kontrolluar modelet, procesin e trajnimit dhe respektimin e masave të sigurisë. Ai tha se OpenAI do të zbatojë të njëjtën praktikë.

Një nga arsyet kryesore të alarmit është incidenti i korrikut, gjatë testeve të brendshme të aftësive kibernetike të modeleve të OpenAI.

Sipas vetë kompanisë, agjentët e AI-së kapërcyen kufizimet që duhej t'i mbanin të izoluar, siguruan lidhje me internetin dhe komunikuan mes tyre përmes kanaleve të paautorizuara.

Agjentët shfrytëzuan dobësi teknike, depërtuan në pjesë të infrastrukturës së OpenAI dhe në sistemet e platformës Hugging Face, ekzekutuan kod në dhjetëra servere dhe siguruan akses të plotë në të paktën një prej tyre.

Veprimet nuk ishin pjesë e detyrës së përcaktuar nga studiuesit. OpenAI e cilësoi ngjarjen si një "sinjal paralajmërues", por sqaroi se nuk u prekën të dhënat e klientëve, funksionimi apo disponueshmëria e produkteve të saj.

Amodei paralajmëroi se një grup agjentësh më të fuqishëm, por me të njëjtat probleme kontrolli, mund të shkaktonte dëme shumë më të mëdha.

Jo ndalim, por kontroll i ritmit

Propozimi nuk kërkon ndalimin e trajnimit të modeleve. Amodei propozon ekspertë të jashtëm brenda laboratorëve të AI-së, standarde të përbashkëta sigurie ndërmjet kompanive dhe koordinim ndërkombëtar.

Pika më e vështirë mbetet përfshirja e Kinës. Çdo ngadalësim vetëm nga kompanitë amerikane mund t'u japë avantazh rivalëve kinezë, ndërsa një marrëveshje globale do të ishte e vështirë për t'u kontrolluar.

Megjithatë, fakti që drejtuesit e Anthropic, OpenAI dhe xAI po mbështesin publikisht të njëjtin shqetësim tregon se frika mbi ritmin e zhvillimit të AI-së tashmë ka depërtuar edhe brenda vetë industrisë/skyweb

Artikuj te sugjeruar

BOTA 14 Shtator08:04

[**Putin: Tregtia brenda BRICS-it arrin në 1.2 trilion dollar**](#)

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka bërë të ditur se tregtia mes vendeve të BRICS-it ka arritur në 1.2 trilion dollarë. Duke fol...

BOTA 14 Shtator00:09

[**Temperaturat e larta ndikojnë edhe te shampanja, autoritete franceze autorizojnë prodhimin e saj me përqindje më të lartë alkooli**](#)

Dashamirësit e shampanjës mund të 'dehen' më shpejt, pasi prodhuesit francezë janë autorizuar për herë të...

BOTA 14 Shtator00:05

[**Zgjedhje të ngushta në Suedi, e djathta ekstreme synon hyrjen për herë të parë në qeveri**](#)

Suedezeit votojnë për parlamentin e ri, në një garë tejet të ngushtë që mund t'i sjellë fitore të ...

BOTA 14 Shtator00:03

[**Budanov: Raundi i ri i bisedimeve për paqe mund të zhvillohet në fillim të tetorit**](#)

Kreu i Zyrës së Presidentit të Ukrainës, Kyrylo Budanov, deklaroi se një raund i ri i bisedimeve të paqes në format trepal...

BOTA 14 Shtator00:00

[**Bëtë "like" aksidentalisht në Instagram? Kreu i platformës tregon nëse personi tjetër merr njoftim**](#)

Një nga situatat më të sikletshme në Instagram është kur i vendosim pa dashje "like" një postimi, sidomos kur b...

BOTA 13 Shtator23:50

[**Tragjedi në Turqi, autobusi përplasat me barrierat dhe përfshihet nga flakët, 2 të vdekur dhe 8 të plagosur**](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në Autostradën Veriore Marmara në Turqi, ku një autobus pasagjerësh që udhëtonte nga D...

BOTA 13 Shtator22:01

[**350 kg kokainë me anije nga Brazili, goditet rrjeti i drogës në Turqi, 9 të arrestuar**](#)

350 kg drogë janë gjetur në një anije të mbërritur nga Brazili në portin e Mersinit, në Turqi, ndërsa nëntë...

BOTA 13 Shtator21:32

[**"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra prangosen pas përleshjes në avion**](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

BOTA 13 Shtator21:31

[**Pas dështimit të negociatave me SHBA-në, Kanadaja kërkon statusin e "anëtarit të asociuar" në BE**](#)

Kanadaja po kërkon të forcojë lidhjet me Bashkimin Europian, pasi bisedimet tregtare me Shtetet e Bashkuara u përplasën me mosmarrë...

BOTA 13 Shtator21:04

[**Droni rus godet trenin në kufirin ukrainas-polak! Shpëtojnë mrekullisht Boris Johnson dhe...**](#)

Një dron rus ka goditur një tren pasagjerësh në Ukrainën perëndimore, vetëm rreth dy kilometra larg kufirit me Poloninë...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra prangosen pas përleshjes në avion

[Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...](#)

AKTUALITET 13 Shtator

[“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

[A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...](#)


Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.